



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-28667/24 datë:28.10.2024



Npi – 01/339 datë: 30.10.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.10.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -X- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 30.10.2024 (e mërkurë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje ka munguar Shkurte Behluli. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtori i DBF-së z.Besnik Ahmeti, Drejtoresha e DSHMS-së znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, pastaj edhe znj.Vlora Hyseni nga zyra për Informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 30.09.2024,
2. Diskutim mbi mbështetjen dhe shërbimet Sociale dhe shëndetësore për komunitetet rom e ashkali,
3. Raporti nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2024,
4. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (diskutim publik)
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024,
6. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (diskutim publik)
7. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 30.09.2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 30.09.2024.**

Diskutim mbi mbështetjen dhe shërbimet Sociale dhe shëndetësore për komunitetet rom e ashkali
Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Meqenëse drejtoresha Mimoza Salihu është prezent në mbledhje, i urojmë mirëseardhje, dhe ndoshta mundet me na informuar pak për këtë pikë.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS: Përshëndetje. Siç e dini në këtë post jamë emëruar që një kohë të shkurtë, dhe po bëj përpjekje që të familjarizohem me punët në këtë drejtori. Ne si drejtori po bëjmë përpjekje që me i mbështetë familjet e komunitetit pakicë që janë në nevojë, dhe kjo mund të vërehet qoftë në ndihmat me pako ushqimore, qoftë me ndërtimin e shtëpive për komunitetin pakicë që po ndodhin në komunën tonë. Në komunën tonë nuk mund të vërehet ndonjë dallim në ofrimin e shërbimeve, qofshin ato shëndetësore qofshin ato sociale, qka do të thot se edhe pjestarët e komuniteteve rom e ashkali që jetojnë në komunën tonë janë të barabartë me komunitetin shumicë. Nëse ka ndonjë pyetje konkrete do të bëj përpjekje të përgjigjem.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Ka qenë dashur që ta kemi një informatë të përgjithshme, mirëpo meqenëse Ushtruesja e Detyrës të Zyra për Komunitete nuk po merr pjesë në mbledhje, e cila do të mund të na jepte informata më të sakta, sepse drejtoresha dihet që është e re në këtë pozitë dhe mund të mos i ketë ende të gjitha informatat. Ne duhet me pas një listë me emrat e anëtarëve ose familjeve me nevoja ekstreme nga komuniteti rom e ashkali.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Para dy muajve ne kemi diskutuar, për listën të cilën e presim ta marrim nga drejtoria, dhe pastaj ne si Komitet ta diskutojmë bashkërisht në mbledhje. Edhe një informacion po ua jap, komuna e ka hapur konkursin për zyrtarin që nevojitet të zyra për Komunitete dhe Kthim, me qka besoj se do të bëhet një zgjidhje e mirë për adresimin e nevojave dhe kërkesave në këtë zyrë.

z.Muhamet Mehmeti: Përshëndetje. Unë e kam pas një takim pune me drejtoreshën e DSHMS-së znj.Mimoza Salihun, ku kemi diskutuar gjerësisht për familjet që kanë nevojë për ndihma, si dhe për familjet që po u ndërtohen shtëpitë nga projekti i përbashkët i OJQ “Jetimat e Ballkanit” nga Halil Kastrati dhe Komunës së Shtimes. Po ashtu kemi diskutuar edhe për dy banorët e komunës tonë të komunitetit ashkali që u është djegur shtëpia, njëri në fshatin Gjyrkovc dhe tjetri në Shtime. Unë kam kërkuar që lista me shkuar përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim, realisht unë e kam listën por pata dëshirë që kjo listë me shku përmes kësaj zyre.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Edhe një informacion i mirëseardhur, përmes platformës e-kosova secili mund të aplikojë për ndihma sociale edhe nëse ka fëmijë mbi moshën 5 vjeqare.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. E tha kryesuesi, se e kemi diskutuar dy muaj përpara qështjen e hartimit të një liste për nevojtarët nga komuniteti pakicë, unë propozoj që kjo mos të shtyhet, por që brenda pak kohe me na e dërguar drejtoresha përmes e-mail se sa pjestar të komitetit pakicë marrin ndihma dhe shërbime shëndetësore.

z.Besnik Seferi: Ne e kemi krijuar një listë, ku dhjetë prej tyre janë futur në programin e ndërtimit të shtëpive. Dy shtëpi janë futur në listë pa e ditur fare, nuk e di se kush ka interferuar aty.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ndoshta mundemi me e organizuar një vizitë të këto familje me juve si drejtoreshë për me pa më afër gjendjen e familjeve në nevojë?

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS: Pjesë të përfituesve prap kanë me qenë pjestar të komunitetve, konkretisht nga programi i përbashkët i OJQ “Jetimat e Ballkanit” nga Halil Kastrati dhe Komunës së Shtimes. Ne mundemi me dalë në vizitë të përbashkët, por realisht unë e kam kërkuar atë listë nga Muhamet Mehmeti.

z.Muhamet Mehmeti: Ne po kërkojmë nëse ka mundësi me qenë dikush pjesë e këtij komisioni për ndërtimin e shtëpive, ose së paku me qenë të njoftuar me gjitha këto zhvillime.

z.Arton Demiri: Përshëndetje. Sa i përket komunitetit rom, ne nuk kemi nevojë për ndërtimin e ndonjë shtëpie. Uroj që të përfundojnë ato që janë filluar, dhe po ashtu uroj që në të ardhmen të përfitojnë ata që kanë nevojë dhe ata që e meritojnë.

Pika 3

Raporti nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Raportin nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2024, e kemi si obligim ligjor nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë. Materialin e keni marrë dhe e keni lexuar, kështu që unë nuk do ta zgjati me detaje por do ti lexoj pikat kryesore të dhëna sipas kodeve ekonomike dhe pastaj nëse ka ndonjë pyetje do te përgjigjem (shih dokumentin). Me rendësi është me përmend faktin se buxheti deri tani është realizuar 70.11%, dhe unë besoj se deri në fund të vitit do ti afrohem shumë realizimit me njëqin për qind.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Faleminderit drejtor për prezantimin. Unë mendoj se shpenzimi i buxhetit deri tani me 70 përqind është një sukses bukur i mirë. Pyetja ime është, te Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, a ka ndonjë shpenzim më shumë në realizimin e disa kërkesave që kanë qenë të adresuara te kjo zyrë?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Në dispozicion i keni edhe rreth pesë mijë euro. Dhe rekomandimi im është që këto mjete financiare të mbetura, të realizohen sepse lehtë mundet me ua marrë pa na pyetur fare përmbaruesi, sikurse ka ndodhur në disa rate tjera. Janë shpenzuar rreth gjashtë mijë euro. Nëse ka ndonjë pyetje tjetër do të përgjigjem.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Faleminderit drejtor, meqenëse nuk ka diskutime tjera, atëherë po kalojmë në pikën tjetër.

Pika 4

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket kësaj pike, tash për tash nuk kemi ndonjë propozim të ri për ndryshim të kësaj draft-rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025. Por meqenëse ky draft duhet me shku në diskutim publik, është e mundur që të kemi ndonjë propozim për ndryshimin e sajë, sepse tash psh. e kemi edhe Mamografin dhe mbase nevojitet caktimi i ndonjë tarife për te, ose për shfrytëzimin e guroreve, këto mund të vijnë si propozime por ta shohim deri në fund.

z.Besnik Seferi: Është bërë punë e mirë për funksionimin e Mamografit në QKMF, por pyetja ime është se a ka staf për këtë paisje?

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS: Po kemi staf, kemi punëtorë që kanë punuar edhe më parë me Mamograf, kështu që tani për tani nuk kemi problem për këtë punë. Shërbimet mund ti marrin secili pacient.

*** Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -X- për vitin 2024 të mbajtur me 30.10.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025.**

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Komuna e Shtimes e ka bërë një propozim-vendim të mirëseardhur që ka të bëjë me banim të përballueshëm dhe social. Mendoj se realizimi i këtij projekti ti ti ndihmonte shumë familje sidomos ato qifte të reja që më lehtë ta zgjidhin problemin e banimit. Tani Ministria paska kërkuar që me bërë një ndryshim te ky vendim, dhe unë besoj se Kuvendi do ta bëjë këtë ndryshim, dhe projekti të shkojë përpara.

z.Besnik Seferi: Propozoj që ne si Komitet ti rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë këtë ndryshim të vendimit të Kuvendit Npi-01/313 të kërkuar nga MAPL-ja.

* Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -X- për vitin 2024 të mbajtur me 30.10.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, miratimin e Vendimit për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së, Nr.020-618-5 dt.17.10.2024.

Pika 6

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, dua të them se nuk e di që përveq Handikosit, a kemi ndonjë Institucion që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuar.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Po kemi edhe "Shkollën Speciale" si dhe "Shtëpinë për Komunitete" që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Faleminderit drejtor, pra kjo draft-strategji ka me shku ndë diskutim publik, bëj ftesë që të marrim pjesë të gjithë në diskutim publik, edhe personat me aftësi të kufizuar, sepse aty mundet secili me dhënë kontributin e vetë. Ne si Komitet i japim mbështetje vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik dhe propozoj që ta miratojmë një rekomandim për Kuvendin.

* Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -X- për vitin 2024 të mbajtur me 30.10.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28.

Pika 7

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Unë po i rekomandoj drejtoreshës si dhe zyrës për komunitete, që ta pranojnë sa më shpejt që është e mundur zyrtarin/en në zyrën për komunitete dhe kthim. Po ashtu kërkoj nga drejtoresha që të na ofrojë një informatë për personat me nevojë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ndoshta kishte me qenë mirë që fillimisht Muhameti me dërgu listën te drejtoresha, e pastaj drejtoresha mundet me na informuar neve. Prp po them kishte me qenë mirë që ju si drejtoreshë por edhe Kryetari pse jo nëse ka kohë me dalë bashkë me neve në teren për të parë për së afërmi gjendjen e familjeve të komunitetit rom dhe ashkali.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:15h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi